



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 133, datë 26.11.2015

PËR

**MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË ME OBJEKT VEPRIMTARINË E
REGJISTRARIT TË TITUJVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, dhe nenit 128 të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Projektstatuti i shoqërisë në proces themelimi “Regjistri Shqiptar i Titujve” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë për mbajtjen e regjistrit të titujve, i paraqitur me shkresën nr. 46154, datë 16.11.2015, nuk përmban disa nga ndryshimet e udhëzuara nga Autoriteti me shkresën nr. 2291, datë 3.11.2015. Kështu:

1. Emri i propozuar i shoqërisë mund të krijojë konfuzionin e një regjistri kombëtar të titujve. Për këtë arsye, vendosja e një fjale nominale, qoftë edhe krahas emrit të propozuar do ta bënte emrin e shoqërisë më të identifikueshëm.
2. Statuti duhet të reflektojë kërkesën që miratimi dhe regjistrimi në QKR i ndryshimit të kapitalit të shoqërisë do të bëhet pas miratimit nga Autoriteti.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e statudit të shoqërisë në proces themelimi që ka për objekt veprimtarinë si regjistrar të titujve, sipas tekstit bashkangjitur, me këto ndryshime:
 - a. Në nenin 1, emri i shoqërisë të bëhet “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG”;

- b. Në nenin 7, pika 4, në fund të paragrafit të shtohet “pas miratimit nga AMF”;
- c. Në nenin 8, pika 5, të shtohet në fillim të fjalisë togfjalëshi “pas miratimit nga AMF”.

2. Ngarkohet drejtoria përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI